



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

KURRIKULA ME ZGJEDHJE

LËNDA: ART PAMOR

KLASA: X

Tiranë, 2016



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

I.	Hyrje.....	4
II.	Korniza konceptuale e programit	6
II.1.	Qëllimet e programit të artit pamor	10
II.2.	Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës	11
II.3.	Lidhja e artit pamor me temat ndërkurrikulare.....	Error! Bookmark not defined.15
II.4.	Lidhja e artit pamor me fushat e tjera kurrikulare.....	Error! Bookmark not defined.16
II.5.	Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj.....	17
II.6.	Ndarja e kohës mësimore për tematikë për secilën klasë.....	21
III.	Shkalla e pestë , përmbajtja	22
III.1	Tematika : Gjuha dhe komunikimi artistik	23
III.2	Tematika: Teknika dhe procese artistike	25
III.3	Tematika: Historia, kultura dhe shoqëria	28
IV.	Udhëzime metodologjike	41
V.	Udhëzime për vlerësimin	42
VI.	Materiale dhe burime mësimore.....	43

Tabelat dhe diagramet

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit.....	8
Digrama 2: Rezultatet e të nxënit të komptencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së artit pamor për shkallën e pestë.	12
Digrama 3: Lidhja ndërmjet artit pamor dhe fushave të tjera.	16
Digrama 4 : Kompetencat e lëndës dhe tematikat e lëndës.	Error! Bookmark not defined. 19
Tabela 1: Kompetencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të lëndës	20
Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë.....	21

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës dhe pjesë integrale e jetës sonë të përditëshme, në të cilën përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, ku ndërvepron kultura dhe shoqëria. Artet dhe studimi i tyre zhvillon njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet lëndëve: art pamor, muzikë dhe teatër, të cilat lidhen ngushtë dhe ndihmojnë në zhvillimin intelektual, emocional, social dhe kulturor të nxënësve nga parashkollori deri në arsimin e mesëm të lartë.

Nëpërmjet përjetimit, vëzhgimit, krijimit, vlerësimit, artet mundësojnë dhënie kuptim ideve, të komunikuarit nëpërmjet krijimeve artistike. Gjuha artistike dhe veprat e artit, të veshura me vlera sociale dhe kulturore të jetës së përditëshme, kontribuojnë në zhvillimin e këtyre vlerave dhe pasqyrojnë historinë dhe shoqërinë njerëzore. Gjithashtu artet luajnë një rol të rëndësishëm në shprehjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore të shoqërisë dhe në zhvillimin, afirmimin dhe ruajtjen e identitetin kulturor dhe atij kombëtar.

Artet përfshijnë artin pamor, muzikën dhe teatrin, në kurrikulën me zgjedhje të arsimit të mesëm të lartë, pikërisht në ***shkallën V dhe VI***.

Kurrikula e arteve¹ në ***shkallën e pestë apo të gjashtë*** fokusohet në zgjerimin e njohurive artistike dhe zhvillimin e tyre në përdorimin dhe zbatimin e gjuhës artistike. Ata krijojnë, performojnë/realizojnë dhe vlerësojnë artet duke krijuar gjykime dhe qëndrime të qarta në klasë, përmes punëve të veta apo të autorëve të ndryshëm dhe zhvillimit historik duke krijuar kompetenca të qëndrueshme dhe të zbatueshme në këto disiplina artistike.

¹Artet, zhvillohen në kurrikulën me zgjedhje të detyrueshme, për shkallën V dhe VI të arsimit të mesëm të lartë përmes tri lëndëve: art pamor, muzikë dhe teatër.

I. Hyrje

Arti pamor është një nga lëndët artistike që përmban fusha e arteve në gjimnaz dhe, ashtu si të gjitha lëndët e tjera brenda fushës së arteve, luan një rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve të kësaj grupmoshe duke u nxitur imagjinatën, zhvilluar ndjenjën e së bukurës dhe duke u mësuar atyre rrugët për të kuptuar botën dhe mjedisin që i rrethon.

Ky program bën të mundur thellimin, zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të njohurive të artit pamor.

Ashtu si programi i artit pamor në ciklin e mesëm të ulët edhe në ciklin e mesëm të lartë ky program ndërton dhe zhvillon në tri kompetenca: *krijimi artistik, realizimi i punimit dhe vlerësimi i veprave të artit.*

Ky program ka për qëllim të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë krijuese, komunikuese, vlerësuese dhe të kuptojnë botën që i rrethon nëpërmjet artit pamor.

Krijimtaria në art, kontribuon në formimin e një identiteti personal e të vetëbesimit dhe ndihmon në krijimin e vetëdijes kulturore dhe ndjeshmërisë artistike. Nxënësit kanë mundësi të krijojnë imazhet e tyre, duke u përfshirë në procesin krijues, duke zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën vizuale, për të komunikuar mendimin e tyre për një audiencë të caktuar. Në këtë nivel ata mësojnë të analizojnë dhe të zhvillojnë ndjesitë e tyre estetike nëpërmjet vlerësimit jo vetëm të punëve të tyre dhe të shokëve/shoqeve, por edhe të veprave të artit, të fakteve dhe imazheve të marra nga historia dhe trashëgimia kulturore e së tashmes dhe e së shkuarës. Nëpërmjet lëndës së artit pamor, nxënësit inkurajohen të bëjnë lidhjen e artit pamor me lëndët e tjera në kurrikul dhe ta shohin artin si një mundësi karriere.

Arti pamor komunikon nëpërmjet gjuhës së simboleve, përmes të cilave nxënësit mësojnë të identifikojnë vlera estetike dhe njerëzore në vepra të ndryshme arti dhe të kuptojnë ndikimin e artit në shoqërinë njerëzore. Përmes kësaj lënde ata do të komunikojnë dhe do të zhvillojnë aftësitë e tyre artistike, jo vetëm përmes gjykitimit estetik, arsytimit, mendimit kritik, por edhe përmes krijimit konkret në punë 2 -3 dimensionale.

Krijimet e ndryshme, që do të realizohen përmes punës në klasë, do t'i motivojnë ata të përfshihen në mënyrë aktive në jetën artistike të shkollës, komunitetit dhe në rang vendi.

Kjo lëndë kërkon që përmes studimit të përmbajtjes, që ajo ofron, të arrihen qëllimet kryesore të lëndës duke dhënë kontributin e saj në *zhvillimin personal* të nxënësve, si dhe duke u dhënë mundësinë atyre të shohin vetveten si pjesë e shoqërisë dhe kontribues aktivë në të. Lënda ndihmon dhe në *përgatitjen e nxënësve si qytetarë aktivë të një shoqërie evropiane*.

II. Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë. Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit**, për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së artit pamor, në mënyrë që ai/ajo të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **Mësuesit**, për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit**, për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara.
- **Hartuesit të teksteve mësimore** dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Programi i artit pamor ka në thelbin e tij krijimin e kushteve për ndërtimin e *kompetencave të lëndës së artit pamor* si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i *temave ndërkurrikulare* nëpërmjet lëndës së artit pamor është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e artit pamor dhe të gjitha arteve të tjera që përbëjnë fushën e arteve në shoqëri dhe në jetën e përditëshme.


Programi, përmban 3 tematika që janë të përbashkëta në të gjitha disiplinat artistike të fushës së arteve dhe krijojnë kushte që nxënësi/sja të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqitet *koha mësimore për secilën tematikë*.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e artit pamor dhe fushave të tjera, në mënyrë që kurrikula e arsimit të mesëm të lartë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie në artin pamor është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin artistik, që zotëron brenda vetes. Në këtë program, *vlerësimi i nxënësve* është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënit.

Programi i artit, nga pikëpamja e organizimit të përmbajtjes, paraqitet në diagramin e mëposhtëm:

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit



Qëllimet e APU

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi/sja:

- të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike;
- të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanëshme;
- të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësi/sja:

- kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

II.1. Qëllimet e programit të artit pamor

Programi i artit pamor, nëpërmjet përmbajtjes së përcaktuar sipas 3 tematikave, ka si qëllim zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe koncepteve për formimin estetik dhe artistik, zhvillimin e aftësive krijuese dhe të menduarit kritik, zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve, për të njohur, analizuar dhe vlerësuar vepra arti nga historia e artit botëror si dhe ajo shqiptare në periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike. Në programin e artit pamor nxënësi/sja mëson të zbulojë ngjashmëritë, ndryshimet, marrëdhëniet, eksperimenton nëpërmjet teknikave artistike dhe gjuhës pamore, zhvillon më tej gjykimin dhe argumentin, duke krijuar një qëndrim të vetin e duke ua paraqitur të tjerëve. Edukohet të punojë në grup dhe ndihet i suksesshëm në artin pamor.

Arti pamor do të mundësojë që nxënësi/sja të:

- analizojë dhe vlerësojë veprat e artit shqiptar, për të ruajtur dhe për të kultivuar identitetin kombëtar, si dhe duke zhvilluar aftësitë e përjetimit *estetik, vlerësimit kritik dhe ndjeshmërisë*;
- analizojë dhe vlerësojë veprat e artit botëror të epokave të ndryshme sipas stilit dhe gjinive, duke zhvilluar aftësitë e përjetimit *estetik, vlerësimit kritik dhe ndjeshmërisë*;
- zhvillojë aftësitë e bashkëpunimit dhe të krijimit të raporteve ndërmjet kulturave, duke ndërvepruar në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike;
- kuptojë forma të ndryshme shprehëse të artit pamor duke zhvilluar aftësitë krijuese, individuale;
- zhvillojë kompetencat pamore për të krijuar dhe realizuar punë të ndryshme arti;

- marrë pjesë në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke vënë në shërbim të mjedisit ku jeton aftësitë dhe talentin e vet;
- japë kontributin personal në zhvillimet artistike pamore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

II.2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së artit pamor

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënies.

Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.

Organizimi i mësimin të artit pamor me bazë kompetencat përqëndrohet në atë që nxënësi/sja duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Kur nxënësi/sja realizon kompetencat e lëndës së artit pamor, ai/ajo njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. Psh. kompetenca e artit pamor “krijimi artistik” përfshin njohuritë mbi gjuhën vizuale të cilat nxënësi/sja i zbulon në objektet, mjedisin që e rrethon, në veprat e artit , duke i përdorur ato në krijimet e veta për të shprehur ndjenja e mendime të realizuara përmes teknikave artistike dhe zgjidhur problemet në detyrën e tyre në mënyrë të pavarur.

Rezultatet e të nxënies të kompetencave të lëndës së artit pamor pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënies të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë.

Në zhvillimin e kompetencave të artit pamor nxënësi/sja gjithashtu zhvillon kompetencat kyçe në lidhje me krijimtarinë, realizimin, vlerësimin e artit pamor, përpunimin e informacionit për veprat e artit, prezantimin e detyrave të zhvilluara, punën në grup, komunikimin efektiv etj. Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së artit pamor mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyç për gjatë vitit mësimor rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat e lëndës së artit pamor që synon të arrijë nxënësi/sja;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e lëndës së artit pamor;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të artit pamor në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor në lëndën e artit pamor.

Digrama 2²: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së artit pamor.

SHKALLA E PESTË/GJASHTË
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike të krijimit, realizimit dhe analizimit të veprave të artit; - gjykon në mënyrë kritike dhe të drejtë mesazhin e veprave të artit; - shprehet qartë dhe komunikon saktë estetikisht dhe artistikisht për vepra të ndryshme arti; - komunikon dhe shprehet nëpërmjet mjeteve shprehëse artistike në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.
Kompetenca e të menduarit
<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi; - zgjidh probleme të ndryshme që lidhen me artin pamor, në jetën e përditshme apo në klasë/shkollë; - zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese gjatë analizës së një vepre arti; - ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim, projekt apo veprimtari në artin pamor.
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - vendos njohuritë pamore në funksion të realizimit të një argumenti, krijimi apo projekti artistik;

² Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe, do të përdoren pamvarësisht klasës në të cilën do të zhvillohet kjo lëndë (në klasën e 10-të, 11-të apo 12 –të).

- përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një punë të vetën mbi artin në përgjithësi apo artin pamor në veçanti;
- zhvillon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë, duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi :

- zhvillon aftësitë menaxhuese artistike lidhur me një projekt artistik;
- drejton aktivitetet artistike brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese;
- inicion aktivitete ndërgjegjësuese ndaj ruajtjes së mjedisit vizualisht pastër.

Kompetenca personale

Nxënësi :

- krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërrmer gjatë veprimtarive artistike;
- merr pjesë dhe kontribuon në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;
- zhvillon vetëbesimin tek aftësitë e veta dhe krijon lirshmëri dhe besim te të tjerët në realizimin e detyrave artistike.

Kompetenca qytetare

Nxënësi :

- promovon me qytetari, vlerat të ndryshme kulturore dhe artistike të vendit apo të krahinës;
- respekton punën dhe mendimin e të tjerëve lidhur me çështje artistike;
- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

Kompetenca digjitale

Nxënësi :

- shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet lidhur aspekte të ndryshme kulturore/artistike;

- përdor, njeh mjete të ndryshme në funksion të informacionit artistik si: audio, video CD, DVD, aparat fotografik dixhital, kamera, etj.

II.3. Lidhja e lëndës së artit pamor me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Arti pamor ka një shumëllojshmëri të veprimtarive në jetën e përditshme dhe është i lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e shumëfishtë sepse ai jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave. të drejtat e njeriut, mjedisi, bashkëjetesa paqësore*, nxënësi kontribuon përmes aktiviteteve artistike duke shpalosur vlerat e kulturës së vet, duke respektuar dhe promovuar vlerat e kulturave të tjera, duke bashkëpunuar vetëm dhe në grup në aktivitete të ndryshme, duke dhënë kontributin e vet, duke u dhënë zgjidhje situatave dhe problemeve të ndryshme pamore/artistike, duke përdorur gjuhë të saktë artistike për të komunikuar vlera dhe qëndrime, duke shpjeguar teknika dhe procese të ndryshme që lidhen dhe me fusha të tjera që ata mësojnë. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi/ja ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave të artit pamor me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.


Nxënësi/sja përdor aftësitë e tij/saj vëzhguese që kanë të bëjnë me simbole, vizatime grafike, për të zhvilluar një marrëdhënie aktive në mjedisin që e rrethon. Nxënësi/ja mëson të komunikojë dhe shprehet përmes gjuhës pamore në krijimet e tij/saj nëpërmjet përdorimit të ideve origjinale, gjuhës artistike, teknikave të larmishme, duke eksperimentuar dhe zhvilluar më tej idetë e veta artistike. Nxënësi/sja familjarizohet me përmbajtje të ndryshme të veprave të artit duke përshkruar, analizuar dhe bërë një gjykim kritik dhe estetik për to.

II.4. Lidhja e lëndës së artit pamor me fushat e tjera kurrikulare

Arti pamor është i lidhur me lëndët brenda fushës së arteve, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Elementet e artit pamor, ritmi, harmonia, dinamika, etj. lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike, si muzikën, teatrin, por edhe me matematikën, gjuhën, shkencat shoqërore. Nxënësit nxiten të bëhen të vetëdijshëm për një numër procesesh, që lidhen me karakteristikat kryesore të kompetencave kroskurrikulare, të cilat krijojnë lidhje me njohuritë në lëndët e tjera. Kompetencat e artit pamor u mundësojnë nxënësve të përdorin informacionin, të zgjidhin problemin, të ushtrojnë mendimin kritik, të zbulojnë metoda pune efektive, të përdorin informacionin dhe komunikimin teknologjik, të zhvillojnë identitetin e tyre personal, të punojnë me të tjerët dhe të komunikojnë në mënyrë të përshtatshme. Kështu që edhe në këtë cikël mësuesit, përmes mësimit të shumë përmbajtjeve mësimore, duhet t'u japin mundësinë nxënësve të konsolidojnë përvojat që ata kanë krijuar dhe që i sjellin në klasë, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave.

Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të artit pamor me lëndë të tjera, të para përmes njohurive:

Digrama 3: Lidhja ndërmjet artit pamor dhe fushave të tjera.



II.5.Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Bazuar në kurrikul, lënda e artit pamor synon të përmbushë 3 *kompetencate lëndës*, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës/e duhet të zotërojë gjatë jetës së tij/saj dhe që arrihen nëpërmjet 3 *tematikave kryesore*.

Kompetencat e lëndës:

- krijimi artistik;
- realizimi i punimit;
- vlerësimi i veprave të artit.

Tematikat e lëndës:

- gjuha dhe komunikimi artistik.
- teknika dhe procese artistike.
- historia, arti dhe shoqëria.

Digrama 4 : Kompetencat e lëndës dhe tematikat e lëndës




Tabela 1: Përshkrimi i kompetencave të lëndës, nëpërmjet tematikave të lëndës

Kompetencat e veçanta	Përshkrimi i kompetencave
Krijimi artistik	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon se si estetika reflektohet në jetën e përditshme; - diskuton mbi artin duke u nisur nga disa qëndrime estetike; - krijon punime arti dy dhe tre dimensionale nëpërmjet përdorimit të larmishëm të gjuhës pamore; - komunikon ide origjinale nëpërmjet krijimeve me teknika të larmishme; - analizon dhe organizon elementët dhe parimet e artit në krijim; - analizon veprën e artit duke i'u referuar elementeve dhe parimeve; - analizon eksperiencat krijuese dhe identifikon se çfarë ka mësuar nga ato; - zbulon përmbajtjen e veprave të artit dhe analizon elementët e gjuhës pamore.
Realizimi i punimit	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi nivel të lartë në përdorimin e teknikave të larmishme artistike gjatë krijimit; - demonstroi aftësi krijuese gjatë realizimit të punimeve si nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra edhe nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës; - demonstroi aftësi në seleksionimin, përgatitjen dhe paraqitjen e punimit; - analizon dhe organizon materialet, gjuhën pamore në krijimet e tij/saj origjinale; - analizon eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit.

Vlerësimi i veprave të artit	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson veprën e artit në kontekstin kulturor dhe atë historik; - zhvillon aftësitë vlerësuese dhe kritike ndaj veprave të artit nëpërmjet mendimit estetik; - identifikon dhe kategorizon veprat e artit sipas teknikës, periudhës, stilit dhe artistit; - demonstron aftësi gjatë përshkrimit, analizës, interpretimit dhe vlerësimit të veprës së artit; - tregon interes ndaj komenteve të tjerëve; - respekton shumëllojshmërinë e opinionëve estetike dhe kritike; - diskuton rreth çështjeve dhe problemeve të artit sot.
-------------------------------------	--

1. Ndarja e kohës mësimore për tematikat³

Lënda e artit pamor zhvillohet në kurrikulën me zgjedhje të detyruar për 36 javë mësimore me nga 2 orë, pra gjithsej 72 orë. Programi i lëndës së artit pamor specifikon peshën (orët e sugjeruara) të secilës tematikë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuar në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

³ Lënda e artit pamor mund të zhvillohet në shkallën e pestë ose në shkallën e gjashtë.

Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknikat dhe proceset	Historia, arti dhe shoqëria	Gjithsej orë
Klasa e dhjetë / dymbëdhjetë	15	20	37	72 orë

III. Përmbajtja e shkallës së pestë

Në programin e lëndës janë paraqitur tematikat përmbajtësore të artit pamor të cilat vazhdojnë të jenë tri:

- *gjuha dhe komunikimi artistik;*
- *teknika dhe procese artistike*
- *historia, arti dhe shoqëria.*

Këto tematika përdoren për të realizuar rezultatet e të nxënit të kompetencave të artit pamor të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike. Për secilën **tematikë** është përcaktuar grupi i njohurive për *shkallën e pestë/gjashtë* (lënda e artit pamor zhvillohet në një vit mësimor dhe mund të zgjidhet nga nxënësit në *klasën e dhjetë ose në klasën e njëmbëdhjetë*) ose *shkallën e gjashtë (klasa e dymbëdhjetë)*;

Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që përmbajtja vjetore përgjatë vitit shkollor duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave në këtë renditje. Kombinimi, ndarja e njohurive dhe koncepteve pamore në situata të nxëni, grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre, është e drejtë e përdoruesve të programit (mësuesit dhe autorët e teksteve);

Për “përkthimin” e programit të artit pamor në tekste mësimore apo programe lëndore për vitin mësimor, aftësitë dhe orët e tematikave do të jenë të shpërndara në tematika dhe njësi mësimore të zhvilluara logjikisht.

III.1.Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik

Përshkrimi i Tematikës

Në këtë tematikë nxënësi/ja:

- shpjegon se si estetika reflektohet në jetën e përditshme dhe përdor elementët e gjuhës pamore për të realizuar idetë e veta përmes imazheve;
- përdor me kompetencë hapat e procesit krijues që nga stimuli, ideja dhe realizimi nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave të duhura artistike.

Procesi i eksperimentit është pjesë e rëndësishme e krijimit artistik pasi ndihmon në aftësimin e nxënësit për të personalizuar tema e subjekte të ndryshme. Personalizimi i temave dhe subjekteve dhe përdorimi i qëllimshëm i elementeve të gjuhës artistike është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit krijues. Gjithashtu nxënësi analizon eksperiencat krijuese dhe zbulon përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës pamore.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

Krijimi artistik

Nxënësi :

- shpjegon se si estetika reflektohet në jetën e përditshme;
- diskuton mbi artin duke u nisur nga disa qëndrime estetike;
- krijon punime arti dy dhe tre dimensionale nëpërmjet përdorimit të larmishëm të gjuhës pamore;
- komunikon ide origjinale nëpërmjet krijimeve me teknika të larmishme;

- analizon dhe organizon elementët dhe parimet e artit në krijim;
- analizon veprën e artit duke i'u referuar elementeve dhe parimeve;
- analizon eksperiencat krijuese dhe identifikon se çfarë ka mësuar nga ato;
- zbulon përmbajtjen e veprave të artit dhe analizon elementët e gjuhës pamore.

Realizimi i punimit

Nxënësi :

- demonstroi nivel të lartë në përdorimin e teknikave të larmishme artistike gjatë krijimit;
- demonstroi aftësi krijuese gjatë realizimit të punimeve si nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra edhe nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës;
- demonstroi aftësi në seleksionimin, përgatitjen dhe paraqitjen e punimit;
- analizon dhe organizon materialet, gjuhën pamore në krijimet e tij/saj origjinale;
- analizon eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit.

Vlerësimi artistik

Nxënësi :

- vlerëson veprën e artit në kontekstin kulturor dhe atë historik;
- zhvillon aftësitë vlerësuese dhe kritike ndaj veprave të artit nëpërmjet mendimit estetik;
- identifikon dhe kategorizon veprat e artit sipas teknikës, periudhës, stilit dhe artistit;
- demonstroi aftësi gjatë përshkrimit, analizës, interpretimit dhe vlerësimit të veprës së artit;
- tregon interes ndaj komenteve të tjerëve;
- respekton shumëllojshmërinë e opinioneve estetike dhe kritike;
- diskuton rreth çështjeve dhe problemeve të artit sot.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
KLASA X- XII	
<ul style="list-style-type: none"> > Estetika: <ul style="list-style-type: none"> - Arti dhe studimi i artit; teoritë e artit; leximi i veprës së artit. > Pika: <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i pikës në komunikimin pamor. > Vija: <ul style="list-style-type: none"> - Funkzioni shprehës i vijës në veprat e artit. > Forma dy dhe tre dimensionale: <ul style="list-style-type: none"> - Marrëdhënia midis formës dy dhe tre dimensionale. (Vëllimi në skulpturë, pikturë dhe arkitekturë) > Ngjyrat: <ul style="list-style-type: none"> - Raporti i ngjyrave në veprat e artit. Vlera simbolike e ngjyrës. > Tekstura: <ul style="list-style-type: none"> - Llojet e teksturave në veprat e artit që karakterizojnë stilin e artistit > Kompozimi: <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i elementëve të artit në një vepër (parimi i ekuilibrit, barazpesha). > Hapësira: 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon se si estetika reflektohet në jetën e përditshme; - diskuton mbi artin duke u nisur nga disa qëndrime estetike; - identifikon arsyet përse njerëzit studiojnë art; - identifikon përdorimin e pikës në vepra të ndryshme të artit dhe dizajnit dhe e përdor për të komunikuar mendimin e tij personal; - studion funksionin shprehës të vijës në vepra të ndryshme artistike si në pikturë, skulpturë, arkitekturë, dizajn; - krijon duke përdorur mundësitë shprehëse të vijës; - identifikon dhe shqyrton kontrastin midis formës së nënkuptuar mbi sipërfaqen dy dimensionale dhe formës reale tre dimensionale; - përdor vëllimin në mënyrë krijuese dhe shprehëse duke u mbështetur në vepra të ndryshme arti; - zbulon mundësitë shprehëse të ngjyrës nëpërmjet studimit të veprave të artit; - zbulon vlerën simbolike dhe komunikuese të ngjyrës në kultura të ndryshme dhe në natyrë; - përdor ngjyrën në mënyrë krijuese dhe shprehëse duke u mbështetur në vepra të ndryshme arti; - shqyrton lloje të ndryshme teksturash duke zbuluar funksionin komunikues të saj në vepra të ndryshme arti; - përdor në mënyrë të qëllimshme teksturën për të komunikuar ide duke u mbështetur në vepra të ndryshme arti;

<ul style="list-style-type: none"> - Koncepti i hapësirës në periudha të ndryshme të historisë së artit. <p>› Proporcionet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trupi i njeriut dhe portreti. 	<ul style="list-style-type: none"> - identifikon rregullat e kompozimit në veprat e artit dhe i përdor ato për tu shprehur në mënyrë personale; - shqyrton llojet e ndryshme të ekuilibrit (barazpesha) se si ato ndikojnë në kompozim dhe në perceptimin e veprës së artit; - identifikon, shqyrton dhe përdor konceptet e hapësirës në krijim; - përdor me efektivitet proporcionet e trupit të njeriut dhe portretit në krijim; - aplikon eksperimentimin me elementet dhe parimet e artit për të krijuar; - analizon veprat e artit, punën e tij dhe të shokut duke iu referuar elementeve dhe mënyrës së organizimit të tyre në krijim.
---	--

III.2. Tematika: Teknika dhe procese artistike

Përshkrimi i Tematikës

Në këtë tematikë nxënësi/ja:

- krijon punë dy dhe tre dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit me kompetencë të teknikave të larmishme artistike;
- zbulon mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, eksperimenton dhe i përdor me kompetencë në realizimin e punimit.

Një vend të rëndësishëm zë përzgjedhja e qëllimshme e teknikave artistike nga nxënësi/sja, eksperimentimi me efektet e ndryshme të tyre për të realizuar idenë dhe për të dhënë mesazhin për një audiencë të caktuar. Gjithashtu, ai/ajo zhvillon aftësitë e tij/saj për të organizuar gjuhën pamore nëpërmjet teknikave të ndryshme artistike dhe ndan eksperiencat krijuese me të tjerët. Demonstron aftësi në seleksionimin, përgatitjen dhe paraqitjen e punimit duke analizuar eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respektuar mendimin e tjetrit.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

Krijimi artistik

Nxënësi :

- shpjegon se si estetika reflektohet në jetën e përditshme;
- diskuton mbi artin duke u nisur nga disa qëndrime estetike;
- krijon punime arti dy dhe tre dimensionale nëpërmjet përdorimit të larmishëm të gjuhës pamore;
- komunikon ide origjinale nëpërmjet krijimeve me teknika të larmishme;
- analizon dhe organizon elementët dhe parimet e artit në krijim;
- analizon veprën e artit duke iu referuar elementeve dhe parimeve;
- analizon eksperiencat krijuese dhe identifikon se çfarë ka mësuar nga ato;
- zbulon përmbajtjen e veprave të artit dhe analizon elementët e gjuhës pamore.

Realizimi i punimit

Nxënësi:

- demonstroi nivel të lartë në përdorimin e teknikave të larmishme artistike gjatë krijimit;
- demonstroi aftësi krijuese gjatë realizimit të punimeve si nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra edhe nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës;
- demonstroi aftësi në seleksionimin, përgatitjen dhe paraqitjen e punimit;
- analizon dhe organizon materialet, gjuhën pamore në krijimet e tij/saj origjinale;
- analizon eksperiencat e tij krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit.

Vlerësimi artistik

Nxënësi:

- vlerëson veprën e artit në kontekstin kulturor dhe atë historik;

<ul style="list-style-type: none"> - zhvillon aftësitë vlerësuese dhe kritike ndaj veprave të artit nëpërmjet mendimit estetik; - identifikon dhe kategorizon veprat e artit sipas teknikës, periudhës, stilit dhe artistit; - demonstroi aftësi gjatë përshkrimit, analizës, interpretimit dhe vlerësimit të veprës së artit; - tregon interes ndaj komenteve të të tjerëve; - respekton shumëllojshmërinë e opinioneve estetike dhe kritike; - diskuton rreth çështjeve dhe problemeve të artit sot. 	
Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
KLASA X-XII	
<ul style="list-style-type: none"> > Vizatimi: <ul style="list-style-type: none"> - Teknikat e vizatimit. > Piktura: <ul style="list-style-type: none"> - Teknikat e pikturës. > Stampimi: <ul style="list-style-type: none"> - Teknikat e stampimit. > Fotografia: <ul style="list-style-type: none"> - Fotografia dixhitale. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi aftësi në seleksionimin, përgatitjen dhe prezantimin e krijimit; - përdori metoda të ndryshme për të paraqitur hapësirën në vizatim (pejzazh, natyrë e qetë, kompozim, etj.) si: mbivendosjen, detajet, perspektivën me një pikë, perspektivën me dy pika, etj; - përdori mjete dhe teknika të larmishme për të krijuar në vizatim si: lapsi, lapustilat, lapsat me ngjyra, pena dhe boja (rapidografi); - aplikoi teksturën ose hijet nëpërmjet përdorimit të linjave si të kryqëzuara, të vijëzuara, të përziera, pikëzimeve, etj, në vizatim; - përdori figurën e njeriut në krijim; - përdori mjete, teknika dhe procese të ndryshme për të krijuar piktura që reflektojnë interesin, imagjinatën dhe idetë personale; - krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (vlerën, intensitetin,

<ul style="list-style-type: none"> - Teknika manuale të përpunimit të fotografisë. - Teknika dixhitale të përpunimit të fotografisë. <p>› Dizajni dhe prezantimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objekt dizajni (projektimi i objekteve) - Grafik dizajni. <p>› Skulptura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teknikat dhe përdorimet. <p>› Konstruksoni:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projektimi, urbanistika. - Skenografia. 	<ul style="list-style-type: none"> kontrastin, etj); - demonstroi aftësi për të identifikuar karakteristikat e teknikave dhe proceseve të stampimit; - përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të stampimit për të realizuar idetë krijuese; - identifikon karakteristikat e fotografisë dixhitale dhe marrëdhënien e saj me fotografinë tradicionale; - krijon kolazhe me fotografi ose përpunon imazhe fotografike me teknika manuale; - përdor teknologjinë për të përpunuar dhe manipuluar imazhe të ndryshme; - krijon dizajnin e objekteve (të një produkti industrial ose artizanal); - identifikon përdorimin e gjuhës pamore në dizajn dhe rëndësinë e saj në komunikimin e idesë; - krijon dizajnin për paketimin e objekteve të ndryshme, logon, ose kopertinën e një libri; - demonstroi aftësi për të krijuar në skulpturë nëpërmjet teknikave të gdhendjes, derdhjes, modelimit ose assemblazhit; - përdor materiale të ndryshme për të krijuar në skulpturë (skulpturë e rrumbullakët, relief); - shpjegon marrëdhënien midis formës dy dimensionale dhe asaj tre dimensionale në skulpturë; - përdor materiale të riciklueshme për të krijuar konstrukcione banesash në miniaturë;
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> - analizon elementet urbanistikë të qytetit, simbolikën dhe funksionin e tyre; - analizon skenografinë si një art i projektimit të skenës në teatër, në kinematografi e në televizion; - projektton dhe realizon në miniaturë një skenë teatri ose spektakli; - mban një bllok skicash dhe shënimesh të cilin e përdor si një burim informacioni; - përdor teknikat artistike për të realizuar idetë në profesione të ndryshme si: dizajni i modës, arkitekti, grafik dizajni, fotografi, etj. - përzgjedh krijimet më të mira për t'i prezantuar në portofolin e nxënësit.
--	--

III.3. Tematika: Historia, arti dhe shoqëria

Përshkrimi i Tematikës:

Në këtë tematikë nxënësi/ja:

- përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra të ndryshme arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore në aspektin historik dhe social kulturor;
- komunikon emocionet dhe gjykimin e tij mbi vepra të ndryshme arti si dhe për punën e tij/saj dhe të shokut/shoqes.

Duke iu referuar historisë së artit dhe kulturës nxënësi/sja, pasuron perceptimin për mjedisin që e rrethon duke e njohur më mirë atë. Identifikon dhe kategorizon veprat e artit sipas teknikës, periudhës, stilit dhe artistit. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësi/sja kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri, gjithashtu respekton opinione estetike dhe kritike të ndryshme. Nxënësi/ja diskuton rreth çështjeve dhe problemeve të artit sot.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

Krijimi artistik

Nxënësi :

- shpjegon se si estetika reflektohet në jetën e përditshme;
- diskuton mbi artin duke u nisur nga disa qëndrime estetike;
- krijon punime arti dy dhe tre dimensionale nëpërmjet përdorimit të larmishëm të gjuhës pamore;
- komunikon ide origjinale nëpërmjet krijimeve me teknika të larmishme;
- analizon dhe organizon elementët dhe parimet e artit në krijim;
- analizon veprën e artit duke iu referuar elementeve dhe parimeve;
- analizon eksperiencat krijuese dhe identifikon se çfarë ka mësuar nga ato;
- zbulon përmbajtjen e veprave të artit dhe analizon elementët e gjuhës pamore.

Realizimi i punimit

Nxënësi :

- demonstroi nivel të lartë në përdorimin e teknikave të larmishme artistike gjatë krijimit;
- demonstroi aftësi krijuese gjatë realizimit të punimeve si nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra edhe nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës;
- demonstroi aftësi në seleksionimin, përgatitjen dhe paraqitjen e punimit;
- analizon dhe organizon materialet, gjuhën pamore në krijimet e tij/saj origjinale;
- analizon eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit.

Vlerësimi artistik

Nxënësi :

- vlerëson veprën e artit në kontekstin kulturor dhe atë historik;
- zhvillon aftësitë vlerësuese dhe kritike ndaj veprave të artit nëpërmjet mendimit estetik;
- identifikon dhe kategorizon veprat e artit sipas teknikës, periudhës, stilit dhe artistit;

<ul style="list-style-type: none"> - demonstroi aftësi gjatë përshkrimit, analizës, interpretimit dhe vlerësimit të veprës së artit; - tregon interes ndaj komenteve të tjerëve; - respekton shumëllojshmërinë e opinioneve estetike dhe kritike; - diskuton rreth çështjeve dhe problemeve të artit sot. 	
Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
KLASA X-XII	
<p>› Histori arti:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme; objekte nga trashëgimia kulturore. (Prehistoria, Arti Egjiptian, Antikiteti (Arti Grek dhe Romak), Arti në mesjetë, Rilindja, Baroku, Neoklasicizmi, Romantizmi, Realizmi, Arti në Lindje, Impresionizmi, Postimpresionizmi, Arti në shek. XX, Arti dhe dizajni sot. Historia e artit Shqiptar⁴). <p>› Eksperiencia artistike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita në studiot e artistëve, punishtet e artizanëve të zonës. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikon veprat e artit dhe zhvillimet artistike në lidhje me periudhën historike dhe vendin; - diskuton ose shkruan rreth historisë së artit duke përdorur një fjalor të zgjeruar artistik; - shqyrton veprat e artit në kontekstin e tyre historik duke i lidhur me ngjarjet historike; - përshkruan karakteristikat dalluese të veprave të artit në periudha historike dhe në kontekste kulturore të ndryshme; - diskuton kushtet sociale që ndikuan veprat e artit; - përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe nga kultura të tjera, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor; - përshkruan simbolet në veprat e artit në lidhje me kontekstin historik;

⁴ Historia e artit shqiptar është mirë të integrohet përgjatë zhvillimit kronologjik të periudhave historike të artit botëror.

<ul style="list-style-type: none"> - Takime me artistë, dizajnë, artizanë, arkitektë etj. › Ekspozita dhe evente kulturore: - Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet. - Vizita në muzeume, (arkeologji, etnografi) galeri arti, qendra kulturore, site arkeologjike, objekte të trashëgimisë kulturore, etj. › Media: - Libra, revista, postera, filma, aparat fotografik, kompjuter, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti; - argumenton dhe komunikon mendimin e tij mbi veprën; - diskuton dhe respekton mendimin e tjetrit; - zbulon një spektër të gjerë të karrierrës në artet pamore; - viziton muze, galeri, qendrën kulturore, site arkeologjike, etj; - merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë e komunitet; - përdor burime të ndryshme informacioni; - prezanton informacionin e mbledhur rreth veprave të artit dhe autorëve të tyre; - analizon dhe prezanton informacionin e mbledhur rreth objekteve të artizanatit dhe trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.
---	--

Qëndrime dhe vlera

Nxënësi/ja:

- › shpreh përmes vëzhgimit, karakteristika të veprave të artit dhe dizajnit, objekteve të trashëgimisë kulturore dhe artizanatit;
- › shpreh ide, ndjenja dhe eksperiencë nëpërmjet artit pamor për një audiencë të caktuar;
- › përdor një fjalor të përshtatshëm artistik kur përshkruan dhe analizon një vepër arti;
- › shpreh idetë e veta për vepra të ndryshme arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore;
- › demonstroi vetëbesim në aktivitete të ndryshme artistike;
- › shprehet dhe komunikon në mënyrë të pavarur;
- › merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike vetëm dhe në grup;

- › përdor imagjinatën dhe kreativitetin gjatë realizimit të një punimi;
- › interpreton objekte nga natyra në mënyrë origjinale;
- › demonstroi vetëbesim në krijimet e veta vetëm ose në grup;
- › bashkëpunon me të tjerë në një veprimtari artistike;
- › respekton diversitetin ndaj kulturave të ndryshme;
- › respekton krijimet e veta dhe të tjerëve;
- › mban qëndrim ndaj veprave të artit, dizajnit, artizanatit dhe objekteve të trashëgimisë kulturore;
- › zbulon dhe respekton trashëgiminë kulturore kombëtare dhe atë të kulturave të tjera;
- › zhvillon frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë krijimit ose zhvillimit të aktiviteteve artistike;
- › demonstroi përqendrim dhe durim gjatë punëve krijuese;
- › demonstroi aftësi për të mbështetur mendimin dhe gjykimin personal si me gojë edhe nëpërmjet të shkruarit.

IV. Udhëzime metodologjike

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënien e artit pamor është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin pamor/artistik që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të artit pamor do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata vëzhgojnë, reflektojnë, zbulojnë mjedisin vizual dhe krijojnë nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar nëpërmjet rezultateve të të nxënësve dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e artit pamor, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore në artin pamor është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, ç'ka u mundëson atyre shprehjen e potencialit intelektual/artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia në artin pamor synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet ***në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien dhe nxënien e integruar.***

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm për sa i përket mënyrë se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete, etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënit në artin pamor;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive bazë të artit pamor;
- rëndësinë e veprimtarive praktike në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale;
- rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- veçoritë e veprimtarive në mënyrë individuale dhe në grup;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit pamor dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të tij;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në kuptimin që në procesin mësimor, mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e mirëmenuar dhe e mirëplanifikuar krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si

punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat e artit pamor, që janë të përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në artin pamor.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi të punojë me situata ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si:

- “Pse e studiojmë artin?”
- “Çfarë është një artist?”
- “Cilat janë mundësitë e karrierës artistike?”
- “Si mund të komunikojmë nëpërmjet artit pamor?” etj.

Në këtë mënyrë ai inkurajohet të reflektojë, të gjykojë dhe të shprehë mendimin e tij hapur. Gjithashtu ai mund ta shohë artin si një mundësi karriere ose si një lëndë të rëndësishme të formimit të tij kulturor dhe të përgjithshëm. Cilësia e mësimdhënies është çelësi për suksesin e nxënësve në mësimin e artit. Mësuesit duhet të inkurajojnë çdo nxënës të besojë se do të jetë i suksesshëm në mësimin e artit, të kuptojnë interesat e nxënësve, nevojat që ata kanë, të ndihmojnë nxënësit të aktivizojnë njohuritë e mëparëshme, të rendisin udhëzimet që do të përdorin duke diferencuar udhëzimet për nxënës me nevoja të veçanta. Po kështu mësuesit duhet të stimulojnë dhe inkurajojnë të gjithë nxënësit duke krijuar mjedise ku nxënësit të kenë mundësi për të eksploruar mbi artin pamor në mënyra që janë të rëndësishme për ta.

Mësuesit mund ta realizojnë këtë nëpërmjet veprimtarive të ndryshme duke nxitur pjesëmarrjen me eksperiencën krijuese dhe me materiale konkrete. Planifikimi i kohës, hapësira e përshtatshme dhe një shumëllojshmëri materiale, teknikash dhe informacionesh janë të rëndësishme për të mbështetur një mësimdhënie efektive. Gjatë procesit të mësimdhënies mësuesit duhet të sigurojnë një shumëllojshmëri aktivitete të bazuara në vlerësimin e nevojave individuale të nxënësve, në nevojat e grupit dhe në praktikat më të mira mësimore. Gjithashtu mësuesit duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë për zhvillimin e

veprimtarive të artit pamor që nxit idetë e reja te nxënësit.

Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin që nga njëra anë të aplikojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integrale me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave pamore/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

V. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së mësimin bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqëndrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Procesi i vlerësimit është një proces i vazhdueshëm. Nëpërmjet dokumentimit dhe vlerësimit të krijimeve, mësuesi merr informacionin mbi njohuritë dhe ecurinë e çdo nxënësi në mënyrë që t'i udhëzojë ata në vazhdim. Ky proces vlerësimi shtrihet që nga vlerësimi dhe vetëvlerësimi i punimeve të nxënësve të realizuara me teknika të larmishme artistike, portofoli me punë artistike, prezantimi me gojë dhe me shkrim, testimi, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj. Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Në artin pamor, vlerësimi mbështetet në parimin e individualizimit, ku çdo nxënës posedon dhe zhvillon prirje të veçanta duke u shprehur në mënyrë individuale dhe në bashkëpunimin e realizimit të temave mësimore në grup.

Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale dhe krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësve dhe objektet e vlerësimit janë krijimi i kompetencave të artit pamor të nxënësve, përmes krijimit, interpretimit dhe vlerësimit. Arritjet në lëndën e artit pamor janë më shumë individuale, prandaj duhet edhe të vlerësohen si të tilla.

Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes *krijimit, vëzhgimit, dhe analizës së veprave të artit* etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Portofoli i nxënësit si me krijimet, shkrimet, prezantimet dhe testimi janë një mundësi objektive e vlerësimit të nxënësit, pasi i përgjigjet edhe vlerësimit sipas kompetencave të lëndës së artit pamor të tilla si: krijimi artistik, realizimi i punimit, vlerësimi i veprave të artit.

Vlerësimi i nxënësve në shkallën e pestë bëhet sipas kompetencave përkatëse që ata duhet të zhvillojnë.

VI. Materiale dhe burime mësimore

Gjatë zhvillimit të mëimit në lëndën e artit pamor, për realizimin e kompetencave, mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi i prek, i shikon, i përdor, etj. Ai përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në artin pamor duke ndihmuar nxënësit të eksplorojnë vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit, etj., duke zhvilluar aftësitë e tyre në studimin e kësaj lënde.

Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore dhe me një fjalor të pastër të gjuhës artistike pamore. Mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai u prezanton/sqaron nxënësve përmbajtjet e caktuara ose shkathhtësitë që ata duhet të realizojnë. Mësuesi u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të medieve detyra dhe projekte të ndryshme.

Mësuesi prezanton, shpjegon dhe demonstroi (kur është e nevojshme) drejtpërdrejt gjatë mësimdhënies në lëndën e artit pamor. Është shumë e rëndësishme për nxënësit dhënia mundësi e përdorimit të njohurive dhe aftësive të tyre në veprimtarinë artistike. Duke u mbështetur në eksperiencën e mëparshme ata përdorin me kompetencë teknikat e ndryshme artistike dhe përpiqen të risin nivelin

profesional për të shprehur sa më qartë idetë e tyre krijuese. Është shumë e rëndësishme që mësuesit i duhet të përdorë kontekstin kulturor të artit, duhet të marrë në konsideratë një larmi formash të artit dhe kulturës nga e gjithë bota.

Programi i artit pamor u jep të gjithë nxënësve mundësinë të zbulojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në përdorimin e një sërë mjedesh dhe teknikash artistike dhe të analizojnë e vlerësojnë veprat e artit. Klasa duhet të jetë gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit në orën e artit.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- fotografi të ndryshme që mbajnë informacionin e duhur për eksplorimin e elementeve të artit në natyrë dhe mjedisin rrethues;
- fotografi të objekteve të ndryshme të artizanatit, të trashëgimisë kulturore, etj;
- riprodhime të veprave të artit dhe postera;
- *mjetet audiovizive si:* TV, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD;
- *mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme arti, artizanati, dizajni etj. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për artin pamor. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese;
- *mjedisi mësimor* (klasa, kabinetet e artit pamor, etj.).